

PËR PËRDITËSIMIN E URDHRIT TË MINISTRIT NR. 72, DATË 2.3.2017, “PËR MIRATIMIN E LËNDËVE VEPRUESE NË PËRMBAJTJE TË PMB-ve”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 19, pika 5, të kreut V, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, i ndryshuar, si dhe të pikës 6.3, të kreut VII, të vendimit nr. 335, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, dhe sipas propozimit të strukturës përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin e ministrit nr. 72, datë 2.3.2017, “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, i ndryshuar, bëhet përditësimi me ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

- a) Rinovohet regjistrimi për 1 (një) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri.
 2. Ky përditësim të pasqyrohet në dokumentet e regjistrimit të PMB-ve, të regjistruara.
 3. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

RINOVOHET REGJISTRIMI (RIREGJISTRIM) PËR LËNDËN VEPRUESE SI MË POSHTË:

Nr.	Emri i zakonshëm dhe numri i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1	Abamectin CAS No 71751-41-2 Avermectin B1a CAS No 65195-55-3 Avermectin B1b CAS No 65195-56-4 Abamectin CIPAC No 495	Avermectin B1a (10E,14E,16E)-(1R,4S,5'S,6S,6'R,8R,12S,13S,20R,21R,24S)-6'-[(S)-sec-butyl]-21,24-dihydroxy-5',11,13,22-tetramethyl-2-oxo-(3,7,19-trioxatetracyclo[15.6.1.14,8.020,24]pentaco-10,14,16,22-tetraene)-6-spiro-2'-(5',6'-dihydro-2'H-pyran)-12-yl 2,6-dideoxy-4-O-(2,6-dideoxy-3-O-methyl-α-L-arabino-hexopyranosyl)-3-O-methyl-α-L-arabino-hexopyranoside Avermectin B1b (10E,14E,16E)-(1R,4S,5'S,6S,6'R,8R,12S,13S,20R,21R,24S)-21,24-dihydroxy-6'-isopropyl-5',11,13,22-tetramethyl-2-oxo-(3,7,19-trioxatetracyclo[15.6.1.14,8.020,24]pentaco-10,14,16,22-tetraene)-6-spiro-2'-(5',6'-dihydro-2'H-pyran)-12-yl 2,6-dideoxy-4-O-(2,6-dideoxy-3-O-methyl-α-L-arabino-hexopyranosyl)-3-O-methyl-α-L-arabino-hexopyranoside	≥ 850 g/kg. abamectin (shuma e avermectin B1a dhe avermectin B1b): min. 800 g/kg avermectin B1a dhe max. 200 g/kg avermectin B1b.	1.4.2023	31.3.2038	Mund të autorizohen vetëm përdorime që lejojnë shkëmbimin e kontrolluar të materialit dhe energjisë me mjedisin përreth dhe parandalojnë lëshimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve në mjedis, veçanërisht përdorimet në serra të përhershme. Të kushtohet vëmendje e veçantë për: - mbrojtjen e operatorëve dhe punëtorëve, duke siguruar që kushtet e përdorimit përfshijnë aplikimin e pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse personale, si përdorimi i dorezave; - efektin e fotolizës në nivelet e mbetjeve të pesticideve në kultura. - Vëmendje e veçantë kërkohet për të siguruar që provat e disponueshme të mbetjeve në të korrat, pasqyrojnë situatën më kritike të mbetjeve. Kur është e përshtatshme, në varësi të zonës, të zbatohen kufizime sezonale për kohën e aplikimit.